



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/A/187/2013
13/02/2013

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në secilën prej 34 (tridhjetekatër) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës ose mbajtësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, ose për atë pjesë të saj, ashtu si përcaktohet në vendimin individual përkatës;

(2) Në secilën prej 34 (tridhjetekatër) kërkesave të referuara në paragrafin (1) më sipër, përveç kërkesave nr. 47126 dhe 52144, Komisioni

urdhëron që

(a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;

(b) Pala përgjegjëse ose çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;

(3) Në secilën prej kërkesave të identifikuara në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësi i kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe

- (4) *Në rastet kur ka më shumë së një pronar, vendimi dhe urdhrat e lartpërmendur nuk ndikojnë në të drejtat përkatëse të bashkëpronarëve.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.
2. Sipas nenit 22 të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullos së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:
 - (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
 - (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejtë të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullos së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetetretë nga 11 nga 13 shkurt 2013 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 690 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e tridhjetetretë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Një kërkesë për pronë bujqësore e cila iu paraqit Komisionit, u tërhoq nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e nëntë kërkesave për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes të seancës degjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi dhjetë kërkesa, të cilat ishin pezulluar më parë në pritje të mbajtjes së seancës degjimore. Gjithsej 690 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës pronësore. Të gjitha kërkesat kanë të bëjnë me prona bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 34 kërkesa të identifikuar në listën e bashkangjitur. Nga këto 34 kërkesa, kërkesat nr. 06160, 06174, 06176, 06178, 06179, 06181, 06182, 06184, dhe 06186 kanë qenë subjekt i një vendimi² të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronës së kërkuar gjatë përpunimit të kërkesës nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Për rrjedhojë, këto kërkesë duhet të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar paraqitësit të kërkesës duke e informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimi i mëparshëm i Komisionit është pavlerë dhe nuk mund të përdoret për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor. Pjesa e mbetur prej 656 kërkesave për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet e tjera pikërisht vendimin KPCC/D/A/186/2012 dhe vendimin KPCC/D/A/188/2012.

9. Të 34 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat e kërkuara ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një

zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksin e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksin e Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t’u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksin I, II dhe III, respektivisht.

²Kërkesa nr. 06160 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/36/2009 datë 23 prill 2009, Kërkesat nr. 06174, 06179, 06181, 06182 dhe 06184 janë vendosur me vendimin KPCC/D/A/5/2007 datë 19 dhjetor 2007, Kërkesa nr 06176 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/2/2007 datë 11 mars 2007, kërkesat nr. 06178 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/3/2007 datë 7 nëntor 2007 dhe kërkesa nr.. 06186 është vendosur me vendimin KPCC/D/A/13/2008 datë 30 prill 2008.

fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundës i të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikt i i armatosur që ndodh i në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë

11. Në katër kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar ose pala që ka shprehur interes ligjor në këtë pronë (“Pala përgjegjëse”) ose nuk ka paraqitur mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka kërkuar të ketë lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën pa ofruar ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni i konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

a. Kërkesat nr. 11742, 47126 dhe 52144

12. Kërkesa nr. 11742 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht nënës së tij. Kërkesat nr. 47126 dhe 52144 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 11742 edhe paraqitësi i kërkesës në kërkesat nr. 47126 dhe 52144 kanë paraqitur secili një fletë poseduese që i tregon secilin mbajtës të pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Të dyja fletët poseduese janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

13. Pala përgjegjëse në kërkesën nr. 11742 dhe pala përgjegjëse në kërkesën nr. 47126 dhe 52144 pohojnë se kanë të drejta ligjore për pronat e kërkuara por dështuan të paraqitin dëshmi në mbështetje të pohimit të tyre.

14. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen.

b. Kërkesa nr. 90133

15. Kërkesa nr. 90133 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të vitit 2002 që e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

16. Fillimisht, pala përgjegjëse pohoi se paraqitësi i kërkesës i kishte dhënë leje për shfrytëzimin e pronës së kërkuar, por më pas pranoi se asnjëherë nuk është autorizuar për të shfrytëzuar pronën e kërkuar.

17. Nisur nga sa u tha më sipër, e bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

2. Kërkesa kontestuese – të tjera

18. Në 30 kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur, pala apo palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara, ose pala që ka shprehur interes ligjor në këto prona (“pala përgjegjëse”) e ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë Komisioni ka arritur në përfundimin se kërkesat duhet të miratohen për arsyet e përmendura më poshtë.

a. Kërkesa nr. 06160, 06174, 06176, 06178, 06179, 06181, 06182, 06184 dhe 06186

19. Kërkesat nr. 06160, 06174, 06176, 06178, 06179, 06181, 06182, 06184 dhe 06186 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të vitit 2001, që e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronave të kërkuara. Fleta poseduese është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

20. Pala përgjegjëse pretendon se ka të drejta ligjore për pronat e kërkuara. Pala përgjegjëse deklaron se familja e tij ka pasur në pronësi pronat e kërkuara deri në vitin 1929 kur ato u konfiskuan nga autoritetet shtetërore. Në mbështetje të pohimit, pala përgjegjëse ka paraqitur si dëshmi një kontratë blerje të vitit 1929 e cila megjithatë është e palexueshme. Komisioni nuk konsideron se kjo është dëshmi e mjaftueshme për të kundërshtuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës.

21. Bazuar në dëshmitë para tij, dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhet të miratohen në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

b. Kërkesat nr. 21465, 21466, 21467, 21468, 29895, 29896, 29897 dhe 29898

22. Kërkesat nr. 21465, 21466, 21467, 21468, 29895, 29896, 29897 dhe 29898 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronave të kërkuara. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të vitit 2000, që e tregon mbajtësin e së drejtës pronësore si pronar të pronave të kërkuara. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 2003 sipas të cilit, paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronat e kërkuara nga babai i tij. Ky vendim i trashëgimisë është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

23. Pala përgjegjëse kërkon të drejta ligjore për pronat e kërkuara duke deklaruar se ai i ka blerë pronat e kërkuara në vitin 2001 nga mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore. Megjithatë pala përgjegjëse nuk ka paraqitur dëshmi në mbështetje të pohimit të tij. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, fillimisht pala përgjegjëse deklaroi se i kishte paraqitur dëshmitë përkatëse të dokumentuara në zyrën rajonale të AKP-së, por më pas pohoi se këto dokumente ishin shkatërruar kur shtëpia ishte djegur pak vite më parë.

24. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* certifikatën e përditësuar për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2008, që i tregon pronat e kërkuara në emër të palës përgjegjëse. Megjithatë, kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, zyrtari kompetent i verifikimit nuk mundi të shpjegojë se mbi çfarë baze ishin bërë ndryshimet në regjistrat kadastralë. Zyrtari i verifikimit mundi të konfirmojë vetëm ekzistencën e një kontrate blerje të lidhur mes paraqitësit të kërkesës, përfaqësuar nga një person i tretë me autorizim si shitës dhe palës

përgjegjëse si blerës, megjithatë kontrata e blerjes kishte të bënte me prona të tjera e jo me pronat e kërkuara.

25. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës konfirmoi se i kishte shitur disa prona palës përgjegjëse me anë të palës së tretë të lartpërmendur në bazë të autorizimit të vlefshëm, por mohoi qartazi që pronat e kërkuara të jenë përfshirë në këto transaksione. Sipas paraqitësit të kërkesës, autorizimi mund të jetë keqpërdorur me qëllim të transferimit të pronave të kërkuara në emër të palës përgjegjëse. Megjithatë, më pas, paraqitësi i kërkesës pranoi ekzistencën e një marrëveshje verbale mes tij dhe palës përgjegjëse dhe se ai tashmë kishte pranuar një shumë të parapaguar nga pala përgjegjëse për pronat e kërkuara. Megjithatë, pasi ka pranuar vetëm një shumë të vogël të hollash të çmimit të pajtuar të blerjes, paraqitësi i kërkesës nuk konsideron se kjo marrëveshje verbale të jetë ligjrisht e vlefshme.

26. Gjatë seancës të 32^{dytë} të mbajtur në dhjetor 2012, Komisioni ka urdhëruar mbajtjen e një seance dëgjimore nga një prej anëtarëve të tij në bazë të nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Paraqitësi i kërkesës, pala përgjegjëse, dhe dy dëshmitarët e propozuar nga pala përgjegjëse, pikërisht vëllezërit e palës përgjegjëse Beshkim dhe Besim Nuha, u ftuan të marrin pjesë në seancë. Vetëm paraqitësi i kërkesës mori pjesë në seancë më 15 janar 2013 në ndërtesën e AKP-së në Prishtinë. Pala përgjegjëse, i cili u ftua sipas rregullit, e shpjegoi mosparaqitjen e tij duke deklaruar se ishte në Austri deri në maj 2013. Sa i takon dëshmitarëve, pala përgjegjëse i cili ka pranuar ftesat e drejtuar dëshmitarëve në adresën e tyre të përbashkët, e informoi Sekretarinë Ekzekutive se vëllezërit e tij nuk do të kishin mundësi të merrnin pjesë pasi ata aktualisht jetonin në Austri.

27. Në seancë, fillimisht paraqitësi i kërkesës përsëriti deklaratën e mëparshme se ai i kishte shitur palës përgjegjëse prona të tjera, por jo pronat e kërkuara. Ai mohoi shprehimisht të kishte autorizuar palën e tretë për shitjen e pronave të kërkuara tek pala përgjegjëse. Në mbështetje të deklaratës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti *inter alia* një kontratë blerje të pavërtetuar të prillit 2001, sipas të cilës paraqitësi i kërkesës i kishte shitur palës përgjegjëse parcela të tjera, si edhe një dëftesë për pagesën e çmimit të blerjes të prillit 2001 për këto parcela. Paraqitësi i kërkesës deklaroi gjithashtu se disa parcela toke të cilat ai ia kishte shitur një pale të tretë, ishin shënuar gabimisht në emër të palës përgjegjëse në regjistrat kadastrale dhe për rrjedhojë regjistrat kadastrale evidentojnë në mënyrë të gabuar disa parcela toke duke përfshirë këtu pronat e kërkuara në emër të palës përgjegjëse.

28. Komisioni konstaton se deklarata e paraqitësit të kërkesës gjatë seancës dëgjimore se ai nuk ia ka shitur pronat e kërkuara palës përgjegjëse, është e hollësishme edhe e besueshme dhe përputhet me deklaratën e mëparshme të paraqitësit të kërkesës para AKP-së. Më tej, Komisioni bën me dije deklaratën e zyrtarit kompetent të verifikimit se nuk janë gjetur dokumente për të sqaruar mbi çfarë baze janë regjistruar pronat e kërkuara në emër të palës përgjegjëse. Pala përgjegjëse nuk ka mundur të paraqitë dëshmi në lidhje me këtë dhe ka dështuar të kundërshtojë deklaratën e hollësishme dhe të shtjelluar të paraqitësit të kërkesës. Më tej, Komisioni vëren se deklaratat e palës përgjegjëse kanë qenë të papajtueshme me atë që kishte shpjeguar se ai i kishte paraqitur të gjithë dëshmitë e dokumentuara në AKP dhe me pas shpjegoi se i gjithë dokumentacioni relevant ishte djegur. Komisioni konstaton se, në këtë rrethana, certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme e vitit 2008, e cila e tregon palën përgjegjëse si pronar të pronës së kërkuar nuk mund të merret në konsideratë për qëllimet e këtij vendimi.

29. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhen të miratohen në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

c. Kërkesat nr. 27691 dhe 44771

30. Kërkesa nr. 27691 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës Dragan Seslija në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht bashkëshortes së tij, Leposava Seslija. Kërkesa nr. 44771 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës Milutin Nikola Seslija në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht vëllait të tij Dragan Seslija, paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 27691. Të dy kërkesat lidhen më të njëjtën pronë. Gjatë përpunimit të kërkesës, bashkëshortja e Dragan Seslijsë, Leposava Seslija e informoi Sekretarinë Ekzekutive se Dragan Seslija kishte ndërruar jetë dhe se ajo kishte trashëguar pronën e kërkuar nga bashkëshorti i saj. Leposava Seslija kërkoi që AKP-ja të konfirmojë e pronësisë për pronën e kërkuar në emrin e saj. Më pas, ajo paraqiti një vendim trashëgimie të vitit 2011 lëshuar nga Gjykata Komunale e Ferizajt, sipas të cilit, ajo ka trashëguar pronën e kërkuar nga bashkëshorti dhe një certifikate për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2011 që e tregojnë pronën e kërkuar në emër të saj. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësit e kërkesës, Dragan Seslija dhe Milutin Nikola Seslija kanë paraqitur një vendim gjykate të vitit 1999 lëshuar nga Gjykata Komunale e Ferizajt, sipas të cilit Ndërmarrja Shoqërore “DP Poloprivredno Dobro” ishte urdhëruar t’i kthente posedimin e pronës së kërkuar Dragan Seslija-s, pronësia e të cilit për pronën e kërkuar ishte vërtetuar gjithashtu me vendimin e lartpërmendur. Më tej, në mbështetje të kërkesës, Dragan Seslija dhe Milutin Nikola Seslija kanë paraqitur një fletë poseduese të vitit 2003 që e tregon Dragan Seslija-n si pronar të pronës së kërkuar.

31. Pala përgjegjëse deklaron se ai ka pasur me qira pronën e kërkuar nga Ndërmarrja Shoqërore (“NSH”) “KB Pasuria Shoqërore”, trashëgimtar i ndërmarrjes shoqërore “DP Poloprivredno Dobro”. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur një kontratë qiraje të vitit 2002 të lidhur mes Ndërmarrjes Shoqërore “KB Pasuria Shoqërore” dhe palës përgjegjëse në lidhje me pronën e kërkuar, për një afat kohor prej pese vitesh. Komisioni konsideron se kjo kontratë qiraje nuk mund të ketë efekt ligjor pasi Ndërmarrja Shoqërore në kohën e lidhjes së kontratës së qirasë nuk ka qenë pronari i ligjshëm. Kjo rrjedh nga vendimi gjyqësor i lartpërmendur i vitit 1999, në bazë të të cilit Ndërmarrja Shoqërore “DP Poloprivredno Dobro” ishte e detyruar t’i kthente Dragan Seslija-s pronën e kërkuar.

32. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhen të miratohen në emër të Leposava Seslija.

d. Kërkesa nr. 38107

33. Kërkesa nr. 38107 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës së kërkuar, e cila përben parcelën nr. 235 me sipërfaqe prej 21 ari e 44 m². Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një aktgjykim të vitit 1994 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kurshumlisë. Aktgjykimi e ka deklaruar të pavlefshëm kontratën e blerjes të vitit 1967 të lidhur mes babait të paraqitësit të kërkesës dhe Ndërmarrjes Shoqërore “Sloga” dhe ka konfirmuar të drejtën pronësore të babait të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar. Me tej, paraqitësi i kërkesës paraqiti një aktgjykim të vitit 1995 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut e Prokupljes, e cila ka lënë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Kurshumlisë. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Me tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë

poseduese të vitit 2007 nga kadastra e zhvendosur në Serbi e cila e tregon babain e paraqitësit të kërkesës si pronar të pronës të kërkuar, pikërisht parcelës nr. 235 me sipërfaqe prej 21 ari e 44 m². Fleta poseduese është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur gjithashtu një vendim trashëgimie të vitit 2002 në bazë të të cilit paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronën e kërkuar nga babai i tij. Po ashtu ky vendim trashëgimie është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

34. Palët përgjegjëse, pikërisht Komuna e Podujevës dhe Klubi i Futbollit “Besiana”, kërkojnë të drejta ligjore për pronat e kërkuara duke deklaruar se prona e kërkuar i ka takuar Komunës edhe i është ndarë Klubit të Futbollit “Besiana” për një afat kohor prej dhjetë vitesh. Në mbështetje të pohimit të tyre, palët përgjegjëse kanë paraqitur një vendim të vitit 2001 të Kuvendit Komunal të Podujevës si edhe një kontratë të përkohshme shfrytëzimi të vitit 2002 të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Klubit të Futbollit “Besiana”. Sipas këtyre dokumenteve, Klubit të Futbollit “Besiana” i është dhënë e drejta e përkohshme e shfrytëzimit të pronës së kërkuar për një afat kohor prej dhjetë vitesh. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* në kadastrën e Kosovës, një certifikate për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2012, që e tregon parcelën nr. 235 në emër të Komunës së Podujevës, megjithatë me një sipërfaqe më të madhe, pikërisht prej 4 ha.

35. Komisioni vëren se certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme e vitit 2012 nuk është përditësuar në emër të familjes të paraqitësit të kërkesës mbi bazën e vendimit të verifikuar pozitivisht të Gjykatës Komunale, respektivisht të Qarkut të Kurshumlisë për rikthimin e së drejtës pronësore të pronave të kërkuara tek familja e paraqitësit të kërkesës. Rrjedhimisht, ajo nuk mund të merret në konsideratë si dëshmi e së drejtës pronësore për palët përgjegjëse. Më tej, Komisioni konsideron se kontrata e paraqitur e shfrytëzimit dhe vendimi i Komunës së Podujevës, që pretendohet se i kanë miratuar palëve përgjegjëse të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit, nuk kanë efekt ligjor, pasi në kohen e lidhjes së kontratës dhe nxjerrjes së vendimit, Kuvendi Komunal i Podujevës nuk ka qenë pronar i ligjshëm. Kjo rrjedh gjithashtu nga vendimi i lartpërmendur gjyqësor i vitit 1995 në bazë të të cilit Ndërmarrja Shoqërore “DP Poloprivredno Dobro” ka qenë e detyruar të kthejë pronën e kërkuar tek familja e paraqitësit të kërkesës.

36. Komisioni vëren se, ndonëse paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposëdimin për parcelën nr. 235 me sipërfaqe prej 21 ari e 44 m², certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme e vitit 2012 e tregon parcelën 235 me një sipërfaqe më të madhe, prej 4 ha. Më tej, Komisioni vëren se nuk ka mospërputhje për madhësinë e pronës së kërkuar në dokumente të ndryshme të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës si dëshmi, në aktgjykimet e vitit 1994 dhe 1995 dhe në veçanti në fletën poseduese të vitit 2007 e përditësuar nga kadastra e zhvendosur, e cila merret si e dhënë kadastralë përkatëse për këtë vendim.

37. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në sipërfaqen prej 21 ari e 44 m².

e. Kërkesa nr.. 38112

38. Kërkesa nr. 38112 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposëdimin e parcelës nr. 238/1 më sipërfaqe prej 88 ari e 90 m². Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një aktgjykim të vitit 1996 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Kurshumlisë. Aktgjykimi e ka deklaruar të pavlefshme kontratën e

shitjes të vitit 1967, lidhur mes gjyshes së paraqitësit të kërkesës si shitëse dhe Ndërmarrjes Shoqërore “Sloga” si blerës dhe ka konfirmuar të drejtën pronësore të gjyshes së paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur gjithashtu një aktgjykim të vitit 1996 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut të Prokupljes i cili ka lënë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Kurshumlisë. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 1996 në bazë të të cilit nëna e paraqitësit të kërkesës ka trashëguar pronën e kërkuar nga gjyshja e paraqitësit të kërkesës, i cili është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive dhe një fletë poseduese të vitit 2007 nga kadastra e zhvendosur në Serbi, e cila e tregon nënën e paraqitësit të kërkesës si pronare të pronës së kërkuar, pikërisht të parcelës nr. 238/1 me sipërfaqe prej 88 ari e 90 m². Fleta poseduese është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur gjithashtu një vendim trashëgimie të vitit 2002, sipas të cilit paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronën e kërkuar nga nena e tij. Ky vendim trashëgimie është verifikuar po ashtu pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

39. Pala përgjegjëse, Ndërmarrja Shoqërore “Perparimi”, e cila është trashëgimtarja e Ndërmarrjes Shoqërore “Sloga”, kërkon të drejta ligjore për pronën e kërkuar. Megjithatë, pala përgjegjëse nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të pohimit të tij. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2008 nga kadastra e Kosovës që e tregon pronën e kërkuar ende në emër të “Koopërativës Bujqësore” të Podujevës.

40. Komisioni konsideron se certifikata e lartpërmendur për të drejtat e pronës së paluajtshme e siguruar *ex officio* e vitit 2008, nga kadastra e Kosovës, nuk është përditësuar në emër të familjes së paraqitësit të kërkesës mbi bazën e aktgjykimit të vitit 1996 të verifikuar pozitivisht, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut e Prokupljes, e cila ka lënë në fuqi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Kurshumlisë duke konfirmuar të drejtat pronësore të familjes së paraqitësit të kërkesës. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të merret në konsideratë si dëshmi e së drejtës pronësore për palën përgjegjëse.

41. Komisioni vëren se, paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin për parcelën nr. 238 me sipërfaqe prej 88 ari e 90 m², ndërsa certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme e vitit 2008 nga kadastra e Kosovës, e tregon parcelën 238 me një sipërfaqe prej 59 ari e 24 m². Komisioni vëren se dokumentet e ndryshme të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës si dëshmi, e tregojnë pronën e kërkuar si 88 ari e 90 m², në veçanti aktgjykimi i vitit 1996 dhe në veçanti fleta poseduese e vitit 2007 e siguruar nga kadastra e zhvendosur, e cila merret si e dhënë kadastrale përkatës për këtë vendim.

42. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në sipërfaqen prej 88 ari e 90 m².

f. Kërkesa nr. 48225

43. Kërkesa nr. 48225 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e parcelës së kërkuar nr. 550 me sipërfaqe prej 52 ari e 29 m². Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese të vitit 2002, që e tregon mbajtësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të pronës së kërkuar. Kjo fletë poseduese është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

44. Pala përgjegjëse kërkon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar. Në mbështetje të pohimit të tij, pala përgjegjëse ka paraqitur deklaratën e vitit 2012 të vërtetuar nga Gjykata Komunale e Malishevës dhe të nënshkruar nga dy dëshmitarë. Në bazë të kësaj deklarate, pala përgjegjëse e ka blerë nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1976, një pjesë të parcelës së kërkuar e cila përben 17 ari.

45. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, paraqitësi i kërkesës pranoi se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore në të vërtetë kishte shitur një pjesë të pronës së kërkuar, pikërisht 17 ari, tek pala përgjegjëse në vitin 1976.

46. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet në emër të paraqitësit të kërkesës në sipërfaqen prej 35 ari e 29 m². Pjesa tjetër e kërkesës duhet të refuzohet pasi mbajtësi i së drejtës pronësore nuk ka qenë pronar i kësaj pjese të pronës së kërkuar menjëherë para ose gjatë kohës së konfliktit të 1998-99.

g. Kërkesat nr. 51690, 51691, 51692, 51693, 51694, 51696 dhe 51697

47. Kërkesat nr. 51690, 51691, 51692, 51693, 51694, 51696 dhe 51697 janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij Radosav Dumanovic. Në mbështetje të kërkesave, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një vendim trashëgimie të vitit 1961 të lëshuar nga Gjykata Rajonale e Podujevës, sipas të cilit Radosav Dumanovic ka trashëguar pronat e kërkuara në pjesën ideale prej 2/3 të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur gjithashtu fletën poseduese të vitit 2008 që e tregon Radosav Dumanovic si bashkëpronar të pronave të kërkuara.

48. Palët përgjegjëse kërkojnë të drejta ligjore për pronat e kërkuara, megjithatë pala e parë përgjegjëse dhe pala e dytë përgjegjëse kanë kërkuar të drejta ligjore për prona të tjera e jo për pronat e kërkuara pasi ato janë notifikuar gabimisht. Mbrojtjet e tyre nuk lidhen me pronat e kërkuara. Pala e tretë përgjegjëse, Sharif Halimi, pohon se ka blerë në vitin 1985, pjesë të pronave të kërkuara nga pala e tretë, Bajram Bajra. Në mbështetje të pohimit, pala përgjegjëse ka paraqitur vetëm një deklaratë më shkrim dore nga ai dhe djali i tij. Megjithatë, një deklaratë e thjeshtë me shkrim dore nga një palë pa asnjë dëshmi tjetër të dokumentuar nuk është e mjaftueshme për të provuar të drejtën pronësore për pronën e kërkuar.

49. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesat duhen të miratohet.

h. Kërkesa nr. 91514

50. Kërkesa nr. 91514 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës pronësore dhe riposedimin e parcelave të kërkuara nr. 130 dhe 131. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të vitit 2003, që e tregon pronën e kërkuar në emër të babait të paraqitësit të kërkesës. Më tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e trashëgimisë të vitit 2003, sipas të cilit paraqitësi i kërkesës ka trashëguar pronën e kërkuar nga babai i saj. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

51. Komisioni vëren se Gjykata Komunale e Mitrovicës ka lëshuar aktgjykimin e vitit 2005 ku ka vendosur për ndarjen e pronave të kërkuara dhe i ka njohur të drejtën pronësore palës së tretë Momir Stojic për një pjesë të parcelave nr. 130 dhe 131. Vendimi është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Më tej, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur ex

officio certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme të vitit 2010, që e tregon babain e paraqitësit të kërkesës si pronar të parcelave nr. 130/1 dhe 131/1.

52. Palët përgjegjëse kërkojnë të drejta ligjore për pronën e kërkuar. Pala e parë përgjegjëse, Afrim Durmishi, në mbështetje të pohimit, ka paraqitur një kontratë të vërtetuar në gjykatë, të vitit 2009, e lidhur mes Momir Stojic dhe Afrim Durmishit, sipas të cilës Afrim Durmishi ka përfutur parcelat nr. 130/1 dhe 131/1. Kontrata e blerjes është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Pala e dytë përgjegjëse, Abit Avdiu, në mbështetje të pohimit të tij, ka paraqitur një kontratë blerje të vitit 2009, e cila nuk lidhet me pronën e kërkuar.

53. Kur u kontaktua nga Sekretaria Ekzekutive, vëllai i paraqitësit të kërkesës, pas vdekjes së paraqitësit të kërkesës në vitin 2011, konfirmoi se pronat e kërkuara ishin shitur pjesërisht tek një palë të tretë Momir Stojic. Më tej, ai ra dakord që kërkesa të përpunohej me parcelat e ndara sipas kadastrës, pikërisht parcelat nr. 130/2 dhe 131/2.

54. Bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet për parcelat nr. 130/2 dhe 131/2. Pjesa tjetër e kërkesës duhet të refuzohet pasi mbajtësi i së drejtës pronësore ka tjetërsuar këto pjesë të parcelave të kërkuara pas konfliktit

55. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon, Komisioni konstaton se në kërkesat e identifikuar në pjesët A, B dhe C të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

56. Rrjedhimisht, pasi paraqitësi i kërkesës në secilën nga kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, kanë provuar të drejtën pronësore pronën e kërkuar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

57. Në kërkesat nr. 47126 dhe 52144 të referuara në kolonat përkatëse të listës së bashkangjitur, uzurpuesit të tanishëm të pronës së kërkuar i është dhënë lejë verbale nga paraqitësi i kërkesës për të shfrytëzuar pronat e kërkuara. Në këto rrethana, duhet të miratohet një urdhër për konfirmimin e së drejtës pronësore në dobi të mbajtësit të së drejtës pronësore pa urdhër dëbimi ose ndonjë formë tjetër e mjetit ndihmës ashtu si përcaktohet më sipër.

B. Kërkesa për kompensim

58. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me

Ligjin Nr. 03/L-079, Komision i nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

C. Vërejtje përmbledhëse

59. Vendimi dhe urdhri i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

60. Nen i 8.8 i Aneksit II i të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komision i konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

61. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e paraqitësve të kërkesës ose mbajtësve të së drejtës pronësore sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e te drejtave të tyre pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në përputhje me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligj i Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftim i i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendim i përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendim i mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme mund të vjelë tarifën për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Version i në gjuhën angleze është version i zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron version i në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA11742	KPA47126	KPA52144	KPA90133			
----------	----------	----------	----------	--	--	--

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA48225	KPA51690	KPA51691	KPA51692	KPA51693	KPA51694	KPA51696
KPA51697	KPA06160 REP	KPA06174 REP	KPA06178 REP	KPA06179 REP	KPA06181 REP	KPA06182 REP
KPA06184 REP	KPA06186 REP	KPA27691	KPA44771	KPA91514	KPA06176 REP	KPA38107
KPA38112	KPA21465	KPA21466	KPA21467	KPA21468	KPA29895	KPA29896
KPA29897	KPA29898					